 - Peshë: 170g/m
 - Rezistenca elektrike maksimale në 20°C: 13.3 ohm/km
 - **Litar kundra ujit** I veshur me material rezistent ndaj ujit

Brryl plastic Ø63

Presioni: SDR 11 (16 Bar)

Materiali: Polietilen

Masa: 63 mm

– **Brryl plastic Ø50**

Presioni: SDR 11 (16 Bar)

Materiali: Polietilen

Masa: 50 mm

– **Brryl plastic Ø25**

Presioni: SDR 11 (16 Bar)

Materiali: Polietilen

Masa: 25 mm

– **Ti plastic Ø63**

Materiali PPR është shumë i përdorur në instalimet e brendshme, është praktik në përdorim dhe shumë rezistent. Dimension 63mm

– **Ti plastic Ø25**

Materiali PPR është shumë i përdorur në instalimet e brendshme, është praktik në përdorim dhe shumë rezistent. Dimension 25mm

– **Ti plastic Ø32 me dalje ½ per sprucator**

Materiali PPR eshte shume I perdorur ne instalimet e brendshme,eshte praktik ne perdorim dhe shume rezistent.Dimension 32mm

– **Ti plastic Ø25 me dalje ½ per sprucator**

Materiali PPR eshte shume I perdorur ne instalimet e brendshme,eshte praktik ne perdorim dhe shume rezistent.Dimension 25mm

– **Sprucator me hedhje 10 m**

Sprucatori shërbën për hedhjen e ujit dhe vaditjen e kopshteve tuaja. Ky sprucator është i montuar nëntokë dhe del në sipërfaqe në momentin e vaditjes. Lidhet me elektosaracineskën dhe panelin komandues për të kryer vaditjen në mënyrë automatike. Këndin e hedhjes së ujit nga 40°-360° dhe largësi nga 10 metra.Presioni 1.7 bar - 4.5 bar

– **Sprucator me hedhje 4 m**

Sprucatori shërbën për hedhjen e ujit dhe vaditjen e kopshteve tuaja. Ky sprucator është i montuar nëntokë dhe del në sipërfaqe në momentin e vaditjes. Lidhet me elektosaracineskën dhe panelin komandues për të kryer vaditjen në mënyrë automatike. Këndin e hedhjes së ujit nga 40°-360° dhe largësi nga 4 metra.Presioni 1.7 bar - 4.5 bar

- **Litar per vinxh** me gjatësi te ndryshme dhe aftesi majtëse per pesha teper te renda, përdoren gjerësisht për ngritjen e paletave si dhe të ngarkesave të tjera gjatë transportimit të tyre. Prodhuar nga një material shumë rezistent si dhe të pajisura me unaza në fundet e tyre për të bërë të mundur kapjen e tyre lehtësisht.
- **Kriketo per mjete GS** aprovuar prej material celiku ,parandalon rrjedhjen e vajit ,vaji mbetet I paster edhe pasperdorimit.Kapaciteti 10 ton .lartessi min 225mm,lartesi ngritjes 145mm,lartersia 80mm,pesha 4.96kg.
- **PUNTO BETONI ME SLIT 0.6-12**

Maje karboni sipas standarteve Europiane

Kendi pergjithshem 130°

Kapje cilindrike

Te kromuara

Per perdorim ne tulla, blloqe betoni dhe suva

Dimensionet (4*75,5*85,6*100,8*120,10*120)mm

–**MASKE PER SALDIM ME RREZE**

Helmet automatike te saldimit ideal per saldim MMA,MIG-MAG,TIG

Llastiki LCD I kristalit I erret automatikisht kur harku saldimit po funksionon dhe shpejt

Kthehet ne statusin e tij transparent kur harku eshte I fikur.

E lehte dhe e pershtatshme per tu mbajtur

Filter erresimi automatic

Filter mbrejttese xhami transparente

Mbrojtese e xhami 90x110

Gjendje e ndritshme 3DIN dhe gjendje e erret 11DIN

Xhami optik 1/1/1/2

Temperature operimit -5-55 °C

Pesha 0.41kg

– **ELEKTRODA 2.5 dhe 4**

ASR -143-2.5x2 Permasat :2.5*300mm Pesha :2.06 kg

ASR -143-4.0 Permmasat :4*4.5mm Pesha :6 kg

Motosharre model Stihl MS 461

ZHVENDOSJA: 76,5 cc (4,7 cu. in.)FUQIA E MOTORIT: 4,5 kW (6,0 kf)

PESHA E KOKEVE: 6,6 kg (14,6 lbs.)

GJATESITË E SHIFREVE UDHËZUESE* : 40 deri në 80 cm (16" deri në 32")

KAPACITETI I KARBURANTIT: 800 cc (27,1 oz.)

Kapaciteti i vajit të zinxhirit: 325 cc (11,0 oz.)

ZINXHIR OIOMATIC®: 33 RS3

Fuqia: Gaz

Motosharre model Stihl MS 441c

Zhvendosja: 4.31 cu. in. (70,7 cm³)

Hapja: 1,97" (50 mm)

Goditje: 1,41 inç (36 mm)

Fuqia: 5,6 HP (4,2 kW) në 9500 rpm

Shpejtësia maksimale e lejuar me shirit dhe zinxhir 13,500 rpm

Ndezja: Electron Magneto Pa frenim

Kapaciteti i karburantit: .77 kuart (.73 l)

Kapaciteti i vajit: .38 kuart (.36 l)

Pesha (më pak shufër/zinxhir): 14,6 lb (6,6 kg)

Gjatësia e shiritit: 16" (40 cm), 18" (45 cm), 20" (50 cm) 25" (65 cm), 28" (70 cm) dhe 30" (75 cm)

Hapësira e zinxhirit: 3/8"

Hundë me dhëmbë: 10 dhëmbë deri në 25" (65 cm) me shufra më të gjata që janë 11 dhëmbë

Zinxhiri i furnizuar: Zinxhiri Stihl 3/8" RS daltë (Pro). zinxhir: 7 dhëmbë

Motosharre model Husqavarna T435

Zhvendosja e cilindrit

2,15 cu.inç

Zhvendosja e cilindrit

35.2 cm³

Prodhimi i fuqisë

2.01 kf

Prodhimi i fuqisë

1.5 kW

Lartësia e zinxhirit te te sharres 3/8"x1.3mm

Tendosje e zinxhirit e montuar ne ane sipas standarteve

Gjatesia e shines 12"(30cm)

E ndertuar me celik special ,rezistent ndaj konsumimit.

Motosharre model Husqavarna 365

Niveli maksimal i zhurmës: 114 dB

Pesha: 6 kg

Gjatësia e shufrës: 38, 70 cm

Rezervuari i vajit: 0,4 l

Burimi i energjisë: me benzinë
Kapaciteti i rezervuarit të karburantit: 65.1 cm
Lartësia e zinxhirit te te sharres 3/8"x1.5mm
Tendosje e zinxhirit e montuar ne ane sipas standarteve

Motosharre model AL-KO BKS 3835

Shpejtësia e zinxhirit: 21 m/s
Pesha: 5.25 kg
Gjatësia e shufrës: , 35 cm
Rezervuari i vajit: 0,21 l
Fuqia: 1200 W
Burimi i energjisë: me benzinë
Kapaciteti i rezervuarit të karburantit: 37.2 cm³
Zinxhiri 3/8" spec. / 91P053X
Shpejtësia zinxhirit 21 m/s
Tensioni zinxhirit I perfshire tek motosharra
Lubrifikimi zinxhirit Automatik
Frena zinxhirit Po (0.12 s)

Motosharre model Makita EA7900P

Motoaharrë me zinxhir të fuqishëm me nisje: valvul dekompresimi që zvogëlon me 70% forcën e operatorit të nevojshëm për të ndezur sharrën me zinxhir
Sistem i shkëlqyer kundër dridhjeve: Zvoglimi dridhjeve ndodh përmes sustave të çelikut të qëndrueshme, rezistente ndaj korrozionit nga vaji dhe benzina
Motori i kësaj sharre siguron fuqi të lartë edhe në rpm të ulët, duke dhënë një rezervë të konsiderueshme fuqie
E pajisur me teknologjinë SLR, kurse karburanti deri në 15%
Modeli PS7310 / 50 vjen me bobinë bar
Gjatësia e shufrës 50 cm
Hapësirë me zinxhir 3/8"
Ana e jashtme e tensionit praktik të zinxhirit. Për të rregulluar tensionin e zinxhirit në mënyrë praktike dhe të shpejtë
Rezervuari i karburantit me kapacitet të madh 0,75 l për përdorim të zgjatur
Evakuim i shkëlqyer i çipave që parandalon bllokimin.

Motosteke model Stihl HT75

Krasitëse 12 metra e gjatë
Zhvendosja 25.4cc
Lartësia e zinxhirit te te sharres 1/4"
Zinxhir sharre I llojit Stihl Oilomatic PM3
Tendosje e zinxhirit e montuar ne ane sipas standarteve
Sistemi I jetegjatesis se filtrit te ajrit sipas standarteve .

Motosteke model Force MT330

E pajisur me motor OxyPower për më shumë fuqi, nivele më të ulëta emetimi dhe konsum më të ulët të karburantit. Fillimi i shpejtë dhe i lehtë, me kontrolle të kombinuara të ndalimit të nisjes së butë, pastrimit dhe ndalimit.
Zinxhiri 3/8
Gjatesia shines 50cm

Motokorse MTD SMART 46 SPB me motor të fuqishëm Briggs & Stratton Seria 450
125 cm³.

Puna 4 në 1 - hedhja e koshit, hedhja anash, hedhja prapa .Pret dhe shpërndan barin e prerë në tokë si një pleh natyral.

Veçoria e nxjerrjes anësore lejon kositësin të kosit bar të gjatë dhe të fortë. Rrotat e pasme të mëdha me kushineta për funksionim të lehtë.

Lehtë për t'u përdorur me rregullim të përshtatshëm të lartësisë në 6 pozicione.

Projektuar për kositje deri në 1000 m2.

Presrse bari model Stihl FS250

Zhvendosja 40.2 CC

Fuqia 2.2 kW

Pesha 6.3 kg

Emri / Numri i modelit FS 250

Marka Stihl

Niveli i presionit të zërit me vegël plastike 95 dB (A)

Motogersher model Stihl HS82R

BURIMI GAZ

PESHA 5.4 kg

GJATESIA E TEHIT 24"

Rrotullime ne minut 3100-ta më e zakonshme

Motokorse model Viking

Gjerisa e prerjes se barit 125cm.

Komoditet I larte ne levizje dhe komandim

Njesi kositese sinkrone

Ekran LCD

Shporte e madhe per mbledhjen e barit 350

Motor I fuqishem 2cilindra OHV

Lartesia e prerjes 30-100mm

Rrotat e perparme 15x6

Rrotat e pasme 18x8.5

Trako korrese Model Viking

Prerja e barit e sakte ,ergonomi e sofistikuuar

Motor me 1 ose 2 cilindra

Freksion elektromagnetik thikash

Rrota te medha me profil qe mos te demtohet bari

Njesi kositese sinkrone me gjersi prerje 110 cm.

Sitem me dy thika te vendosur pjerret

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedurë prokurimi, është mbështetur punes nga grupi i ngritur për hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kritereve të vecanta teknike, të procedurës në referencë.

Gjithashtu NJP është bazuar në nenin 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenin 2, pika 2/c dhe nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e nevojave, specifikimeve teknike, fond limit dhe kritereve të veçanta teknike nga grupi i punës i ngritur me urdher të titullarit të AK, Nr. 170 Prot, datë 26.01.2023

Data e hapjes së ofertave planifikuar date 20.02.2023 Ora: 10:00

- www.app.gov.al
- **Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip.**
- **Dokumentat pa pagesë.**

Njësia e prokurimit, bazuar në parashikimet ligjore dhe në objektin e prokurimit, vendosi kriteret e kualifikimit, të cilat gjejnë pasqyrim në Shtojcën 7 të DST –ve, kritere, të cilat u konsideruan si të nevojshme për përmbushjen e kontratës, në përpjestim me përmasat dhe veçoritë e objektit që prokurohet dhe konkretisht, si më poshtë vijon:

KRITERET E PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT të pa ndryshueshme nga ato të miratuar nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d. Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimeve bazuar në natyrën dhe përmasat e kontratës, specififikimet teknike, sasia e kërkuar e mallit, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia gjykon vendosjen e kriterëve si vijon :

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore (2019,2020,2021) nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së parashikuar te kontrates.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 1 dhe 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe vërtetimin.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve te fundit ushtrimore (2019,2020,2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse Dega e Tatim Taksave te konfirmuara nga ky autoritet shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe bilancet.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kriteri do të konsiderohet i përmbushur edhe në rastet kur operatorët ekonomik zgjedhin të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021)

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:*

*"c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:***

- i) *totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;*
- ii) *ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;*
- iii) *iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE duhet të paraqesë bilancet siç kërkohet në pikën 2.2.2.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe

në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore të Vitit 2022 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), për të cilat duhet të paraqesë një vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale

2.2.4 Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 dhe neni 40 pika 7/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më e vogël se 19 % e vlerës së perlllogaritur të kontratës.

- Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvorjet e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shihen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvorjes së mëparshme të realizuara me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shihen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pikë 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvorjet e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që përvorjet të ngjashme për procedurat e thjeshtuara të jenë në vlerën jo më të vogël se 19 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvorjet e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **ISO 9001: 2015** të akredituar nga Institucione të Huaja ose vendase gjithashtu të paraqesë edhe certifikatën e akreditimit, objekti i së cilës të jete në përputhje me objektin që prokurrohet.

Argumentim: Kërkesa e cilësisë të përcaktuar është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pikë 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë

kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

2.3.3-Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar per mallrat objekt prokurimi kjo e vertetuar nepermjet dokumentave orgjinal ose të noterizuar si perfaqesues i kompanise prodhuese per te gjithë mallin/mallrat objekt prokurimi. Ne rast paraqitje autorizimi distributori, operatori ekonomik duhet te paraqesi ne leter angazhim ose akt marreveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre (*e perkthyer ne shqip dhe e noterizuar*). Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëebsite kjo e nevojshme per autoritetin kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet . Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020

“Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

“Dokumentacioni i kërkuar më sipër paraqitet nga OE me anë të formularit të vetëdeklarimit, sipas shtojcës së përcaktuar në DST dhe sipas Nenit 26 pika 1 të VKM nr.285 datë 19.05.2021. Gjithashtu bazuar në pikën 6 të Nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, theksojmë se dokumentat e kërkuara nga AK për përmbushjen e pikës, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.4 Ne menyre qe te krahasohet pajtuesmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese **katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve e prodhuesit/ve te mallrave** objekt prokurimi,(e perkthyer ne shqip dhe e noterizuar), ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte mallrat qe do te ofrohen.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

“Dokumentacioni i kërkuar më sipër paraqitet nga OE me anë të formularit të vetëdeklarimit, sipas shtojcës së përcaktuar në DST dhe sipas Nenit 26 pika 1 të VKM nr.285 datë 19.05.2021. Gjithashtu bazuar në pikën 6 të Nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, theksojmë se dokumentat e kërkuara nga AK për përmbushjen e pikës, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.5-Per materialet elektrike, OE duhet te paraqese **katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve**, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmiteti CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6, si dhe”, në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara

Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te verifikoje qe specifikimet teknike te paisjeve te propozuara nga operatoret ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike te përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike .

E gjykojme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Me anë të venies ne dispozicion ne fazen e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike, certifikata cilesie , certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kerkesave dhe garanton Autoritetin Kontraktor per cilesine dhe standartet e larta nderkombetare dhe te perditesuara sipas teknologjise se re dhe bashkekohore.

“Dokumentacioni i kërkuar më sipër paraqitet nga OE me anë të formularit të vetëdeklarimit, sipas shtojcës së përcaktuar në DST dhe sipas Nenit 26 pika 1 të VKM nr.285 datë 19.05.2021. Gjithashtu bazuar në pikën 6 të Nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, theksojmë se dokumentat e kërkuara nga AK për përmbushjen e pikës, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.6-Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “ofertë teknike” i paraqitur nga autoriteti kontraktor ne formën e një table (pjesë e dokumentacionit të specifikimeve teknike), kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga ofertuesi për të gjithë artikujt e listës, në plotësim të kësaj kerkese dokumenti “ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si mëposhtë:

Nr	emertimi i artikujve	njesia	sasia	emertimi kompanise prodhuese, adresa, ëeb-siti	emertimi i katalogut	referenca ne katalogje/	part number i prodhuesit	standarti i cilesise
						kod i original		

Emri, adresa dhe ëeb-sit i kompanise prodhuese ose distributor i autorizuar, me produktet e te cileve operatori ekonomik do te paraqitet ne ofertim. “emertimi i katalogut te prodhuesit ose distributorit te autorizuar, referenca e produkteve te kerkuara, ne faqen me nr.____, te

katalogut_____, dhe/ose prospekti teknik_____, te shenuar me shenje te dukshme per tu treguar, ne te cilen autoriteti kontraktor duhet te gjeje specifikimet e plota teknike te ofruaranga ofertuesi.

SHENIM: *mosplotesimi i ofertes teknike per te gjithë zerat e kerkuar eshte kusht per skualifikim.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6, si dhe”, të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kerkese është kërkuar ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te verifikoje qe operatori ekonomik dispozicion ne fazen e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi,skeda teknike,certifikata cilesie ,certifikata konformiteti,raporte testimi si dhe ploteson specifikimet t teknike te paisjeve te kerkuara.

2.3.7- Operatorët ekonomikë pjesmarrës duhet te paraqesin mostrat (*kampionet*) sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DST dhe mallrave të paraqitur në ofertën e tyre teknike (*nga një kampion për çdo mall objekt të prokurimit me Nr.Rendor25,26,32,33,34,37,39,48,55,59,60,61,64,65,67,69,70,72,78,79,96,98,123,124,130,135,136,147,149,151,152,156,160,161,178,186,188,190,192,206,208,210,214,216,217,220 sipas renditjes në tabelën e Shtojcës Nr.10*), ditën e hapjes se ofertave ne oren dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, per secilin prej produkteve.

Gjithashtu mosdorëzimi i këtyre mostrave në kohë përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik ofertues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra ne zbatim te tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, ato janë përzgjedhur për artikujt që kanë sasi të konsiderueshme të cilët janë më të kërkuarit. Vetë Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me këtë kriter, arsyeton:

”KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret të tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimin të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave për disa prej produkteve objekt prokurimi, ”Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit

Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërish çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë.

2.3.8-Për mallrat e kerkuara duhet të jepet 1(një) vit garanci nga dita e lëvrimit të mallit. Kushtet e garancisë do të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

“Dokumentacioni i kërkuar më sipër paraqitet nga OE me anë të formularit të vetëdeklarimit, sipas shtojcës së përcaktuar në DST dhe sipas Nenit 26 pika 1 të VKM nr.285 datë 19.05.2021. Gjithashtu bazuar në pikën 6 të Nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, theksojmë se dokumentat e kërkuara nga AK për përmbushjen e pikës, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3.9-Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

“Dokumentacioni i kërkuar më sipër paraqitet nga OE me anë të formularit të vetëdeklarimit, sipas shtojcës së përcaktuar në DST dhe sipas Nenit 26 pika 1 të VKM nr.285 datë 19.05.2021. Gjithashtu bazuar në pikën 6 të Nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, theksojmë se dokumentat e kërkuara nga AK për përmbushjen e pikës, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3.10-Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamioncine	1	Pronësi ose me qira

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).
- b) Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

“Dokumentacioni i kërkuar më sipër paraqitet nga OE me anë të formularit të vetëdeklarimit, sipas shtojcës së përcaktuar në DST dhe sipas Nenit 26 pika 1 të VKM nr.285 datë 19.05.2021. Gjithashtu bazuar në pikën 6 të Nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, theksojmë se dokumentat e kërkuara nga AK për përmbushjen e pikës, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

- Pas finalizimit të këtij procesi për përgatitjen e specifikimeve teknike, grupi i punës, bazuar në nenet 34 dhe 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 12, 13, nenin 45 pika 2. 76 të VKM Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, filloj punën për përlllogritjen e vlerës limit të kontratës objekt

prokurimi, bazuar pikes b/ të nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit:

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përlogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet ti referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) *çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe*
- b) *studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) *çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) *çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Grupi i Punës, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për llogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Lidhur me këtë proces, grupi i punës ka argumentuar dhe dokumentuar referuar materialeve bashkelidhur, konkretisht:

Ne rastin konkret AK i është referuar nenit 76 pikes 1 germa “b” te VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ” Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

- *Sa i përket respektimit të pikës “b”, Grupi i Punës, bazuar në rregullat e tregut, ka kryer studimin e tregut nëpërmjet marrjës së ofertave, për të njohur për aq sa është e mundur, nivelin e tregut aktual. Operatorët Ekonomik të përzgjedhur në mënyrë rastësore për marrjen e ofertave për testimin e tregut, janë subjekte tregtare të licensuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara në faqet on-line respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushen objekt prokurimi.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet Teknike të mësipërme janë në përputhje me nenet: Neni 4, pika 38/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2; 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Theksojmë se ‘Specifikimet Teknike’ i shërbejnë AK për të patur garanci se malli i ofruar do të jetë në parametrat dhe në cilësinë e duhur.

Shënim: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skuklifikim.

Të gjitha kriteret në mënyre më të hollësishme pasqyrohen në DST dhe konkretisht në Shtojcën 7 të **“KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT”**, që ndodhen në dosjen e tenderit objekt prokurimi.